




Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE/PRANIMAR/BORËZUAR: DATUM/PRIMILJEN/OSTAVLJEN:			
DATE-RECEIVED-SUBMITTED:			
Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit	Shif. klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. i faqeve Br. Stranica No. Pages
01	10	345	8



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Bazuar në nenin 10 dhe 15 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 17/10 qershor 2016); Auditorja e Përgjithshme, miraton:

RREGULLORE (ZKA) NR. 01/2023

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES (ZKA) NR. 01/2021 PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS, RREGULLORES (ZKA) NR. 02/2021 PËR KLASIFIKIMIN E VENDEVE TË PUNËS DHE RREGULLORES (ZKA) NR. 03/2021 PËR PRANIMIN DHE KARRIERËN

Prishtinë, 13 mars 2023

KAPITULLI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

1. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është ndryshimi dhe plotësimi i:

1.1. Rregullores (ZKA) Nr. 01/2021 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës;

1.2. Rregullores (ZKA) Nr. 02/2021 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Zyrën Kombëtare të Auditimit; dhe

1.3. Rregullores (ZKA) Nr. 03/2021 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit.

KAPITULLI II NDRYSHIMI DHE PLOTËSIMI I RREGULLORES (ZKA) NR. 01/2021 PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS

Neni 2

Neni 13 i Rregullores bazike ndryshohet si në vijim:

Neni 13 Njësitë organizative mbështetëse

1. Njësitë organizative mbështetëse janë:

1.1. Departamenti për Çështje Juridike dhe kundër Mashtrimeve;

1.2. Departamenti për Komunikim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar;

1.3. Departamenti për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore;

1.4. Departamenti për Buxhet dhe Financa:

1.4.1. Divizioni për Buxhet dhe Raportim;

1.4.2. Divizioni për Financa;

1.5. Departamenti për Shërbime të Përbashkëta:

1.5.1. Divizioni për Logjistikë;

1.5.2. Divizioni për Administrimin e Dokumenteve;

1.5.3. Divizioni për Përkthime.

1.6. Departamenti për Teknologji të Informacionit.

1.7. Njësia e Prokurimit.

3. Njësia e Auditimit të Brendshëm funksionon në bazë të legjislacionit përkatës.

Neni 3

Neni 14 i Rregullores bazike, nënparagrafi 3.3 “një (1) pozitë” ndryshohet në: dy (2) pozita.

Neni 4

Neni 22 nënparagrafi 1.3 i Rregullores bazike ndryshohet si në vijim:

1.3. Kryen organizimin dhe realizimin e të gjitha angazhimeve protokollare të Auditorit të Përgjithshëm, si dhe koordinon e ofron mbështetje për pjesëmarrjen e punonjësve të ZKA-së në grupe ndërkombëtare të punës dhe projekte të përbashkëta të auditimit;

Neni 5

Neni 23 i Rregullores bazike, riformulohet si në vijim:

Neni 23

Departamenti për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e këtij departamenti, janë:

- 1.1. Përcaktimi i objektivave të departamentit në përputhje me strategjinë dhe objektivat e ZKA-së dhe dizajnimi i planeve vjetore të punës të detajuara për t'i përmbushur këto objektiva;
- 1.2. Zhvillimi, zbatimi dhe monitorimi i të gjitha procedurave për plotësimin e vendeve të punës në përputhje me procedurat e rekrutimit të ZKA-së;
- 1.3. Ofrimi i shërbimeve dhe këshillave për personelin e ZKA-së për të siguruar se ZKA është duke zbatuar praktikat më të mira në menaxhimin e personelit;
- 1.4. Hartimi i Strategjisë së Zhvillimit Profesional në përputhje me SNISA-t përfshirë programet për trajnim fillestar dhe edukimin e vazhdueshëm profesional, koordinon aktivitetet me departamentet përkatëse për hartimin dhe zbatimin e Planit Vjetor të Trajnimit, si dhe bashkëpunon me IDI-në për zhvillimin profesional të personelit të ZKA-së;
- 1.5. Administrimi i databazës për menaxhimin e të dhënave të personelit (dosjet personale, nivelet e certifikimit dhe pushimet);
- 1.6. Përgatitja e të gjitha ndryshimeve në paga dhe procesimi në sistem të pagesave (*Payroll*) në baza mujore;
- 1.6. Analizimi dhe vlerësimi i proceseve dhe procedurave të brendshme, si dhe jep rekomandime për ndryshime/përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit në punë;
- 1.7. Ofrimi i përkrahjes administrative e profesionale në proceset si:
 - 1.7.1. Realizimin e planit të trajnimit dhe zhvillimit profesional të stafit
 - 1.7.2. Caktimi i objektivave;
 - 1.7.3. Vlerësimi Vjetor i Performancës;
 - 1.7.4. Promovimi i stafit;
- 1.8. Ofron mbështetje për personelin në procesin e deklarimit të pasurisë;
- 1.9. Siguron dhe ofron informata për Drejtorin e Përgjithshëm rreth procedurave të trajnimit të ZKA-së, me qëllim që të sigurojë se misioni i ZKA-së është përmbushur.
- 1.10. Harton raporte periodike e vjetore varësisht nga kërkesat ligjore e institucionale.

2. Departamenti për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore udhëhiqet nga drejtori, i cili i raporton Drejtorit të Përgjithshëm.

3. Në sistematizimin e vendeve të punës në Departamentin për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore përfshihen këto pozita:

- | | |
|--------------------------------------|----------------|
| 3.1. Drejtor i departamentit | një (1) pozitë |
| 3.2. Zyrtar i burimeve njerëzore | një (1) pozitë |
| 3.3. Zyrtar për zhvillim profesional | një (1) pozitë |

Neni 6

Pas nenit 23 të Rregullores bazike, shtohet një nen i ri i numëruar si neni 23A me tekstin si në vijim:

Neni 23A Departamenti për Buxhet dhe Financa

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e këtij departamenti, janë:
 - 1.1. Caktimi i objektivave të departamentit në përputhje me strategjinë dhe objektivat e ZKA-së dhe dizajnimi i planeve vjetore të punës të detajuara për t'i përmbushur këto objektiva;
 - 1.2. Planifikimi dhe përgatitja e propozim-buxhetit të ZKA-së;
 - 1.3. Ekzekutimi i pagesave dhe transaksioneve të tjera financiare;
 - 1.4. Drejtimi i funksionimit dhe administrimit të financave në ZKA;
 - 1.5. Menaxhimi dhe ofrimi i shërbimeve me qëllim të ofrimit të mbështetjes për të gjithë personelin e ZKA-së;
 - 1.6. Analizimi dhe vlerësimi i proceseve dhe procedurave të brendshme dhe dhënia e rekomandimeve për ndryshime/përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit në punë;
 - 1.7. Përgatitja/hartimi i Pasqyrave Financiare Vjetore, raportimi periodik te Drejtori i Përgjithshëm dhe Auditori i Përgjithshëm si dhe përgatitë të dhëna për raportin vjetor të performancës;
 - 1.8. Realizon të gjitha zotimet sipas kërkesave;
 - 1.9. Siguron dhe ofron informata për Drejtorin e Përgjithshëm dhe e këshillon atë rreth menaxhimit financiar, procedurave, kontrolleve financiare, , me qëllim se të gjitha proceset administrative dhe teknike të ZKA-së janë duke operuar në mënyrë efikase dhe efektive.
2. Departamenti për Buxhet dhe Financa udhëhiqet nga drejtori, i cili i raporton Drejtorit të Përgjithshëm.
3. Divizioni drejtohet nga udhëheqësi, i cili raporton te Drejtori i Departamentit.
4. Në sistematizimin e vendeve të punës në Departament përfshihen këto pozita:

4.1. Drejtor i departamentit	një (1) pozitë
4.2. Udhëheqës i divizionit	dy (2) pozita
4.3. Zyrtar i buxhetit dhe financave	dy (2) pozita

Neni 7

Neni 33 paragrafi 2 i Rregullores bazike, ndryshohet si në vijim:

2. Rritja apo zvogëlimi i numrit të punonjësve në pajtim me ligjin vjetor të buxhetit dhe rrethanat juridike lidhur me sistematizimin nuk krijon nevojë për ndryshimin dhe plotësimin e kësaj Rregulloreje. Dispozitat e ligjit vjetor të buxhetit rreth numrit të punonjësve në ZKA, bëhen pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje.

KAPITULLI III
NDRYSHIMI DHE PLOTËSIMI I RREGULLORES (ZKA) NR. 02/2021 PËR
KLASIFIKIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË ZYRËN KOMBËTARE TË AUDITIMIT

Neni 8

1. Në tërë tekstin e Rregullores bazike, "Departamenti për Buxhet dhe Burime Njerëzore" ndryshohet me: Departamenti për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.

2. Në tërë tekstin e Rregullores bazike, "Divizioni për Buxhet dhe Financa" ndryshohet në: Divizioni për Buxhet dhe Raportim.

Neni 9

Pas nenit 11 të Rregullores bazike shtohet një nen i ri i numëruar si neni 11A me tekstin si në vijim:

Neni 11A

Drejtor i Departamentit për Buxhet dhe Financa

1. Drejtori i departamentit ushtron detyrat, autorizimet dhe përgjegjësitë për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e personelit të departamentit.
2. Kualifikimet themelore për këtë vend pune:
 - 2.1. Diplomë fakulteti;
 - 2.2. Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale që ndërlidhet me vendin e punës;
 - 2.3. Tre (3) vjet përvojë menaxheriale.
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – C2.

Neni 10

Neni 16 i Rregullores bazike ndryshohet si në vijim:

Neni 16

Udhëheqës i Divizionit për Financa

1. Udhëheqësi i Divizionit zbaton detyrat, autorizimet dhe përgjegjësitë për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e personelit të divizionit.
2. Kualifikimet themelore për këtë vend pune:
 - 2.1. Diplomë fakulteti;
 - 2.2. Pesë (5) vite përvojë pune profesionale që ndërlidhet me vendin e punës.
3. Grada e pagës për këtë vend pune është: ZKA – C5.

Neni 11

Shtojca e Rregullores bazike, plotësohet si në vijim:

Pozita	Kategoria	Grada
Drejtor i Departamentit për Buxhet dhe Financa	KMD	ZKA-C2
Udhëheqës i Divizionit për Financa	KUD	ZKA-C5

KAPITULLI IV

NDRYSHIMI DHE PLOTËSIMI I RREGULLORES (ZKA) NR. 03/2021 PËR PRANIMIN DHE KARRIERËN NË ZYRËN KOMBËTARE TË AUDITIMIT

Neni 12

Neni 5 i Rregullores bazike, pas paragrafit 3 shtohet një paragraf i ri i numëruar si paragrafi 4, si në vijim:

4. Nëse ndonjë pozitë e kategorisë profesionale të auditorëve mbetet e lirë, konkursi shpallet për gradën më të ultë të kësaj kategorie. Kjo rrethanë nuk paraqet nevojë për ndryshimin dhe plotësimin e Planit të Rekrutimit.

Neni 13

1. Neni 9 nën-nëparagrafi 1.8.3 i Rregullores bazike, në fund të fjalisë shtohet: jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj.

2. Neni 9 nënparagrafi 1.10 i Rregullores bazike, riformulohet si në vijim:

- 1.10. Informata tjera të cilat konsiderohen të nevojshme përfshirë llojin e dëshmimeve për përgatitjen arsimore dhe përvojën e punës.

Neni 14

Neni 16 i Rregullores bazike, pas paragrafit 5 shtohet një paragraf i ri, i numëruar si paragrafi 6, si në vijim:

6. Bazuar në praktikat e mira ndërkombëtare për zhvillimin e procedurave konkurruese, DMBNJ harton udhëzuesin për procedurat e përzgjedhjes bazuar në meritë, i cili miratohet nga Auditori i Përgjithshëm. Udhëzuesi, ndërmjet tjerash, përfshinë kërkesat e shpalljes së pozitës, praktikat e hartimit të listës së ngushtë dhe mënyrat e vlerësimit të kandidatëve.

Neni 15

Neni 17 i Rregullores bazike, pas paragrafit 2 shtohet një paragraf i ri, i numëruar si paragrafi 3, si në vijim:

3. Pavarësisht dispozitave të kësaj Rregulloreje, për rekrutimin e personelit sipas nenit 44 dhe 45 të Rregullores (ZKA) Nr. 02/2021 për klasifikimin e vendeve të punës në ZKA

konkurrimi zhvillohet, përshtatshëmrisht, sipas legjislacionit përkatës për këtë kategori të zyrtarëve publikë dhe nuk mbahet testimi me shkrim.

Neni 16

1. Neni 18 paragrafi 1 i Rregullores bazike ndryshohet si në vijim:

1. Testimi me shkrim i kandidatëve duhet të mbahet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas hartimit të listës së kandidatëve sipas nenit 17 paragrafit 1 të kësaj Rregulloreje.

2. Neni 18 paragrafi 2 i Rregullores bazike, "tri (3) ditë" ndryshohet me: dy (2) ditë.

Neni 17

Neni 19 paragrafi 1 i Rregullores bazike ndryshohet si në vijim:

1. Intervista mbahet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas hartimit të listës së kandidatëve sipas nenit 17 paragrafit 1 të kësaj Rregulloreje ose mbajtjes së testimit me shkrim nëse aplikohet. Kandidatët njoftohen së paku dy (2) ditë para mbajtjes së intervistimit.

Neni 18

Neni 20 paragrafi 1 i Rregullores bazike, në fund të paragrafit shtohet fjalia: Komisioni nuk rekomandon kandidatin i cili ka marrë më pak se 60 pikë në vlerësimin e përgjithshëm.

Neni 19

Neni 30 paragrafi 3 i Rregullores bazike, "gjashtë muaj (6) muaj" ndryshohet në: një (1) vit.

Neni 20

1. Neni 37 i Rregullores bazike, pas paragrafit 4 shtohet dy (2) paragrafë të rinj të numëruar si paragrafi 5 dhe 6, si në vijim:

5. Pavarësisht dispozitave të këtij neni, për plotësimin e vendit të punës në gradën më të lartë të kategorisë profesionale të auditorëve, auditorëve specialistë, zhvillohet procedurë konkurruese e përzgjedhjes duke u zbatuar dispozitat e nenit 36 të kësaj Rregulloreje.

6. Pavarësisht dispozitave të këtij neni, kriter për lëvizje brenda kategorisë është kalimi i kohës minimale prej (1) viti në pozitën ekzistuese me një gradë më të ulët.

Neni 21

Neni 55 nënparagrafi 1.4 i Rregullores bazike, fjala "ligj" ndryshohet në: legjislacion.

KAPITULLI V
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 22

Dispozitat e veçanta lidhur me emërtimin e vendeve të punës

Dispozitat e kësaj Rregulloreje lidhur me emërtimin e vendeve të punës kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave të çdo akti tjetër sekondar të ZKA-së.

Neni 23

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Prishtinë, 13 mars 2023

Vlora SPANCA



Auditore e Përgjithshme